

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

Nr. 15-BD/2025
Prishtinë: 22.04.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nën paragrafi 5.8 dhe 5.13 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 dhe 1.20, dhe nenit 33, paragrafi 6 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. të protokollit 8648/24, dhe në mbështetje të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet MMPHI-së dhe OIRK-së të nënshkruar më datë 17.03.2025, me nr. të protokollit 1600/25, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 22.04.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet **Procedura e Ekzekutimit të Buxhetit për Periudhën e Përkohshme**, i cili përcakton parimet dhe procedurat për ekzekutimin e shpenzimeve financiare të OIRK-së për vitin 2025, në përputhje me kategoritë buxhetore të përcaktuara në Memorandumin e nënshkruar me MMPHI: a) Paga dhe Mëditje, b) Mallra dhe Shërbime, c) Kompensime të tjera.
2. Procedura e Ekzekutimit të Buxhetit e miratuar është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe zbatohet për të gjitha procedurat e shpenzimeve të lidhura me mjetet e ndara nga linja buxhetore **50400 – Subvencionet dhe Transferet (Grantet Qeveritare)** për vitin 2025.
3. **Bordi Drejtues obligohet të sigurojë zbatimin e kësaj procedure** në të gjitha vendimarrjet dhe veprimet që ndërlidhen me planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve. **Autorizimi i shpenzimeve bëhet nga Kryetari i Odës**, në përputhje me dispozitat e Statutit dhe aktet e brendshme në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

Procedura për Ekzekutimin e Buxhetit për Periudhën e Përkohshme

1. Ekzekutimi i Finacave

- 1.1. Buxheti i OIRK-së ekzekutohet sipas projeksioneve të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes OIRK-së dhe MMPHI-së.
- 1.2. Kryetari i OIRK-së ka autorizim për aprovimin e shpenzimeve deri në vlerë prej 2,000.00€ brenda muajit.
 - a) Kërkesa për nevojën e shpenzimeve mund të paraqitet nga Organet e Odes.
- 1.3. Për shpenzimet që tejkalojnë shumën e përcaktuar me paragrafin 1.2. të këtij neni, Bordi Drejtues i OIRK-së aprovon shpenzimin për nevojat e parapara sipas nenit 1.1.
- 1.4. Me rastin e furnizimit, shfrytëzimit të shërbimit apo shpenzimeve që janë në shërbim të OIRK-së dhe tejkalojnë vlerën 2,000.00€, Bordi Drejtues do të siguroj të paktën 3 (tri) oferta nga ofertuesit sipas ftesës për ofertë.
- 1.5. Përjashtim nga paragrafi 1.4 i këtij neni, në rast se furnizimi apo shërbimi i nevojshëm ka afinitete të veçanta që nuk mund të ofrohen nga operatorë të tjerë ekonomik, Bordi Drejtues mund të përzgjedh furnitorin apo shërbimdhënësin edhe pa u siguruar 3 (tri) oferta të operatorëve ekonomik.
- 1.6. Për nevojat e përcaktuara sipas paragrafit 1.4 të këtij neni, Bordi Drejtues do të caktoj Komision të përbërë prej 3 (tre) anëtarëve të Bordit Drejtues. Komisioni ka kryesuesin i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të komisionit.
- 1.7. Komisioni për furnizim dhe shërbime pas zhvillimit të procedurave për përzgjedhje të ofertave do të përgatisë raportin i cili do t'i paraqitet për aprovim Bordit Drejtues.

2. Kriteret për përzgjedhjen e operatorit ekonomik

- 2.1. Komisioni me rastin e pranimit të së paku 3 (tri) ofertave të operatorëve ekonomik, përzgjedhjen e ofertës do ta bëj në bazë të këtyre kriterëve, nëse me nenet paraprahe nuk është paraparë ndryshe:
 - 2.1.1. Oferta më e arsyeshme ekonomikisht;
 - 2.1.2. Çmimi më i ultë i ofruar; dhe
 - 2.1.3. Konformiteti cilësor i furnizimit apo shërbimit të ofruar.
- 2.2. Komisioni me rastin e përzgjedhjes do t'i japë përparësi konformitetit cilësor, duke u mbështetur në arsyeshmërinë e çmimit të ofruar nëse nuk është përcaktuar ndryshe me nenet paraprahe.

3. Arka

- 3.1. Zyrtari përgjegjës për financa do të jetë i autorizuar që të ruaj në kasafortë të OIRK-së para të gatshme në shumë prej maksimum 100.00€ brenda muajit.

- 3.2. Paradhëniet nga vlera e caktuar me paragrafin 3.1 të këtij neni ekzekutohen me aprovim të Drejtorit Ekzekutiv të Odes.
- 3.3. Shpenzimet me para të gatshme për një transaksion të vetëm mund të bëhen deri në shumë prej 100.00€. Çdo pagesë përtej shumës së tillë duhet të bëhet përmes transaksionit bankar.
- 3.4. Shpenzimet nga ky fond gjithashtu duhet të ruhen dhe të mirëmbahen nga zyrtari përgjegjës financiar i OIRK-së në Cash Flow.